



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr.456/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “Noti Construction shpk & NNT Bini” -Obiliq, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë Operatori Ekonomik: “ Lirigzoni sh.p.k & Liringzoni S”-Skenderaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Shkëlzen Haradinaj” me numër të prokurimit: 616-19-1810-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/ –Komuna e Prishtinës, më datën: 27.08.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Noti Construction shpk & NNT Bini” -Obiliq, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Shkëlzen Haradinaj” me numër të prokurimit: 616-19-1810-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Prishtinës .

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës me titull: Ndërtimi i rrugës Shkëlzen Haradinaj” me numër të prokurimit: 616-19-1810-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Prishtinës, dhe lënda kthehet ne **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Noti Construction shpk & NNT Bini” Obiliq, aprovet pjesërisht si e bazua, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Data e njoftimit për kontratë në KRPP është bërë me dt: 02.04.2019.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 26.04.2019.

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 26.04.2019.

Kërkesa për rishqyrtim është bërë me dt: 15.07.2019.

Përgjigje e kërkesës për rishqyrtim nga AK është bërë me dt: 17.07.2019.

Operatori ekonomik ankues “Noti Construction shpk & NNT Bini” -Obiliq, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 29.07.2019 me nr. 456/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Shkëlzen Haradinaj” me numër të prokurimit: 616-19-1810-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/– Komuna e Prishtinës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 52, 59, 61, dhe 72, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 39.8, të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 07.08.2019, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 19.08.2019, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim :

Përgjigje nr. 1

Eksperti i OSHP-së sqaron se bazuar në pretendimet e OE ankues për disa pozicioni që AK i ka klasifikuar si çmime jo-normalisht të ulëta për OE ankues.

OE ankues në ankesën e tij sqaron se nga AK me dt :29.05.2019 kemi pranuar kërkesë për sqarime lidhur me pozicionet :

Pozicioni nr. 1 nën pozicioni 1,2 dhe 1.10;

Pozicioni 2 nën pozicioni 2.1;2.2;2.3;2.4 dhe 2.5

Pozicioni 3 nën pozicioni 3.1;3.2 dhe 3.6

Pozicioni 7 nën pozicioni 7.1;7.2;7.3 dhe 7.4

Pozicioni 1 nën pozicioni 1.1;1.3 dhe 1.4

Pozicioni 3 nën pozicioni 3.2

Pozicioni 1 nën pozicioni 1.1.1;1.1.2;1.1.3 dhe 1.1.4

Pozicioni 3 nën pozicioni 3.3.1

Eksperti i OSHP-së sqaron se në pozicionet që pretendon AK-Komuna e Prishtinës së OE ankues ka çmime jo-normalisht të ulëta, ne përmasën dhe parallogarite e OE ankues gjinden disa pozicione që OE ankues ka këto çmime:

Pozicioni 1 (Punët paraprake) - Poz. 1.1=0.10 € ; Poz. 1.2=0.10 €; Poz. 1.10= 0.50 €.

Pozicioni 2 (Punimet e dheut) - Poz. 2.1 = 0.70 € ; Poz. 2.2 = 0.10 €; Poz. 2.3 = 0.20 €; Poz. 2.4 = 1.80 €
Poz 2.5 = 5.00 €.

Pozicioni 3 (Mbistruktura) - Poz. 3.1 = 5.00 €; Poz. 3.2 = 5.00 € ; Poz. 3.6 = 9.00 €.

Pozicioni 7 (Sinjalizimi horizontal)-Poz.7.1 = 1.00 €; Poz.7.2 = 1.00 €; Poz.7.3 = 1.00 €; Poz.7.4=3.00€.

Pozicioni 1.0 (Punët e dheut)- Poz. 1.1 = 0.10 € ; Poz. 1.3 = 0.70 € ; Poz. 1.4 = 0.70 €.

Pozicioni 3.0 (Punët metal punuese) - Poz. 3.1 = 70.00 €.

Pozicioni 1 (Instalimet elektrike) - Poz. 1.1.1 = 0.70 €; Poz. 1.1.2 = 4.20 €; Poz. 1.1.3 = 1.50 €
Poz. 1.1.4 = 0.90 €.

Pozicioni 3 (Zhvendosja dhe rehabilitimi i rrjetës ekzistuese në trase të re) - Poz. 3.3.1 = 3.00 €.

Gjate shikimit të këtyre pozicioneve nga shikimi i parë shihen si çmime të ulëta pasi që ka çmime nga 0.10 €, 0.20 €, 0.50 €; 0.90 €; 1.50 € ; 1.80 € ; 3.00 €; 5.00 €; 9.00 €; 70.00 €, por AK duke marrë për bazë formulën për rregulla jo-normalisht të ulëta ka qenë detyrë të bëjë krahasimin dhe të shikojë mundësitë për kryerjen apo moskryerjen e këtij projekti nga OE ankues (NOTI & BINI), pasi që neni 61 i LPP-se dhe rregullat për tender jo normalisht të ulët e përcaktojnë qartë Çmimin jo-normalisht të ulët.

Pasi që Neni 1 (qëllimi) paragrafi 1.2 i Rregullave për Tender Jo-Normalisht të ulët (citim):

1.2 Në çdo rast , kur ka një prag për tender jo-normalisht të ulët, ndalohet përjashtimi automatik i ofertave jo-normalisht të ulëta pa përdorur një procedurë interpartes me operatorin përkatës ekonomik për shqyrtimin e tenderit i cili konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normalisht i ulët.

Paragrafi 3 & paragrafi 4 i kësaj rregullore e përcakton metodën e krahasimit të ofertave me çmim jo normalisht të ulët.

Neni 3 i Rregullores për Tender Jo-Normalisht të Ulët:

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;

i.i. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;

i.i.i. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

3.2 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 3.1 të këtyre rregullave, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.

Neni 4 i Rregullores për Tender Jo-Normalisht të ulët

Neni 4 Procedura e shqyrtimit (interpartes)

4.1 Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me Nenin 61 të LPP dhe paragrafit 3.1 ose 3.2 të këtyre rregullave, një tender i tillë nuk mund të refuzohet pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme që shkaktojnë tenderin veçanërisht të ulët.

4.2 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkojë me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët".

4.3 Operatori Ekonomik do t'i përgjigjet me shkrim Autoritetit Kontraktues. Nëse jo, tenderi do të refuzohet.

4.4 Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të marrë në konsideratë:

4.4.1 ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;

4.4.2 çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;

4.4.3. çfarë do kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose

4.4.4. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

4.5. Përveç elementeve të tenderit të përcaktuara në nenin 4.4 të këtyre rregullave, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:

4.5.1. elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet.

4.6 Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet ose:

4.6.1. Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë; ose

4.6.2 Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, në përputhje me nenin 61 të LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, “Njoftim për refuzim të tenderit abnormalisht të ulët”, brenda dy dite nga data e vendimit.

4.7 Tenderuesi në fjalë do të informohet për rezultatin final të vlerësimit.

Paragrafi 3 dhe 4 i Nenit 61 të LPP-së thotë:

3. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrë të njëjtë siç i trajton edhe tenderët tjerë.

4. Pas marrjes parasysh të informacioneve edhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin.

Eksperti i OSHP-se sqaron se AK duhet të përdorë formulën për Rregullat e Tenderëve me çmime jo-normalisht të ulëta, edhe nëse OE ankues eliminohet sipas formulës (Rregullat për Tender jo-normalisht të ulët) AK duhet ti kërkojë sqarime, por në rastin konkret OE ankues nuk eliminohet sipas formulës se “Rregullave për Tender jo-normalisht të ulët”, por ka çmime në disa pozicione të ulëta dhe AK duke u bazuar në këtë arsyetim e ka eliminuar OE ankues sipas nenit 61 të LPP-së.

Bazuar në pretendimin e OE ankues, se ky OE ka mundësi të ekzekuton punimet edhe me këto çmime, dhe nëse OE nuk eliminohet sipas formulës “Rregullave për Tender Jo normalisht të ulët”, AK duke u bazuar në nenin 1 dhe 6 të LPP-së, ti krahason çmimet e OE ankues dhe OE-ve tjerë se a mund të ekzekuton punët sipas këtyre çmimeve, pasi që edhe interesi i AK-se është që të kursejë buxhetin sipas nenit 1 dhe 6

te LPP-së, pra duke u bazuar në nenin 1 dhe 6 te LPP-se (ruajtja e parasë publike dhe ekonomiciteti dhe efikasiteti), AK mund të kërkoj rritjen e sigurimit të ekzekutimit OE ankues sipas nenit 30.4 te RRUOPP-së, dhe nëse OE nuk e pranon rritjen e sigurimit AK mund ta refuzoj ofertën si OE me çmim jo normalisht te ulet, dhe nëse OE ankues pranon rritjen e sigurimit, AK ofertën e tij ta trajtoj njëjtë me OE të përgjegjshëm.

Pretendimi i OE ankues pjesërisht i bazuar.

Përgjigje nr. 2

Eksperti i OSHP-se sqaron se bazuar ne pretendimin e OE ankues lidhur me çmimin jo-normalisht te ulet, sqaron se Neni 30.4 i RRUOPP-së thotë: “30.4 Shuma e sigurimit të ekzekutimit do të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës. Kur përcaktohet përqindja e sigurimit të ekzekutimit, në rast të kontratave me vlerë të mesme ose të madhe, AK do të siguroj që përqindja mjafton për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata. Autoriteti kontraktues, pasi që të jetë përputhur me nenin 61 te LPP-se, ka mjaft arsye për të besuar se operatori ekonomik e ka dorëzuar një tender të pa-zbatueshëm (jo-normalisht te ulet), gëzon të drejtën që përqindjen e kërkuar të sigurimit te ekzekutimit ta rris për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata”.

Pra, AK mund të kërkoj rritjen e sigurimit të ekzekutimit dhe të veproj ne harmoni me këtë nen të RRUOPP-së (30.4).

Pretendimi ankimor i OE ankues pjesërisht i bazuar.

Përgjigje nr. 3

Eksperti i OSHP-së bazuar në pretendimet ankimore sqaron se:

Nëse OE-të kane gabime ne para masa apo mos-plotësime të para masës, AK duhet të veproj sipas nenit 41.15 të RRUOPP-së(citim):

Ne rast se OE, ofron çmimin me 0.00 Euro për një artikull të veçantë mund të ketë arsye të ndryshme dhe për këtë arsye nevojitet qe të dërgohet një pyetje sqaruese tek Operatori Ekonomik duke kërkuar shpjegim për pozicionin 0.00 Euro.

1. Nëse Operatori Ekonomik pranon se ai artikull i veçantë nuk është i përfshirë në tender, tenderi duhet të refuzohet.

2. Nëse Operatori Ekonomik thotë se ky artikull është ofruar falas, tenderi duhet të refuzohet pasi që dhuratat nuk janë të pranueshme.

AK duhet te analizoj te gjitha pozicionet e OE-ve dhe te bej krahasimin e çmimeve dhe plotësimin e çmimeve te OE-se se a i kane plotësuar dhe llogaritur siç duhet para masën. Pra, AK ne fazën e rivlerësimit të këtë parasysh çmimin dhe të analizoj ofertat e përgjegjshme dhe ti kërkon sqarime shtese OE për pozicionet e paraqitura si më lartë, kur ka çmime 0.10 €, 0.20 €, 0.50 €, 0.90 € etj . Dhe të kërkoj sqarime për këto çmime dhe nëse OE përgjigjet pozitivisht të kërkoj rritjen e sigurimit sipas Nenit 30.4 të RRUOPP-së.

AK duhet ti kalkuloj ofertat ne rast se ndodh që ndonjë OE nuk e ka plotësuar ndonjë pozicion të para masës të veproj sipas nenit 41.15 te RRUOPP-së. Pasi siç pretendon OE ankues që OE i rekomanduar ka një rast te tille.

Ne rast se AK ka dyshime ne çmime jo normalisht të ulëta mund të veproj sipas nenit 30.4 të RRUOPP-së dhe të kërkoj rritjen e sigurimit me shume se 10% (p.sh. 20%, 30%, 50% etj te vlerës se projektit) aq sa e sheh të arsyeshme AK-ja.

Siç pretendon OE ankues se edhe OE i rekomanduar ka çmime që janë të ulëta, por kjo ka qenë bindëse për AK-ne sip.sh.poz 1 (Punët paraprake),nenpozicioni 1.4 apo 1.10 qe kane çmime 0.40 € dhe 0.20 €. Pra, siç shihet nga kjo mendojmë se OE i rekomanduari ka këto pozicione me këto çmime që ndoshta OE me këto çmime mund ti ekzekutoj punimet, dhe kjo duhet te analizohet edhe për OE tjerë se a mund ti ekzekutojnë punimet me çmime të tilla (jo-normalisht të ulëta).

OE i rekomanduar ka ofertuar me çmim 298,348.54 €,kurse OE ankues ka ofertuar me çmim 284,489.92 €, pra dallimi në mes të OE ankues dhe OE së rekomanduar është 13,858.60 €

Bazuar ne këto sqarime AK është përgjegjëse për respektimin e këtyre rregullave dhe LPP-së, ky pretendim është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar (për arsyen që u cek ne përgjigje në pretendimet ankimore),andaj propozojmë qe te anulohet Vendimi i AK dhe lënda te kthehet ne **rivlerësim**.

Operatori ekonomik “Noti Construction shpk & NNT Bini” Obiliq, përmes parashtresës me shkrim të datës: 21.08.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes parashtresës me shkrim të datës: 19.08.2019, ka njoftuar, Autoriteti Kontraktues, lidhur me mendimin e ekspertit edhe pse shkresat i kanë pranuar me kohë të njëjtë nuk janë përgjigjur.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 27.08.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i AK-së dhe eksperti profesional i prokurimit ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Binaku deklaroj: Pajtohem i pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues, ne mendojmë se vlerësimi nga Autoriteti Kontraktues është bërë me shkelje të mëdha për shkak çmimeve abnormalisht të ulëta kanë kërkuar dokumente shtese ne i kemi dorëzuar dhe sqaruar dhe nuk na është përgjigjur për këtë arsye, Ndërsa për OE të rekomanduar për poz për shtylla elektrike e ka çmimin 40 euro dhe ne e kemi 240 euro e që konsiderojmë që është çmim abnormalisht i ulët për të rekomanduar nuk është kërkuar sqarim se si mund ta implementojë kontratën respektivisht këtë pozicion.

Konsideroj që nuk është bërë trajtimi i barabartë i OE-ve.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Sallahu deklaroj: Ne si Autoriteti Kontraktues kemi bërë vlerësimin e të gjitha ofertave dhe pas pranimi të kërkesë për rishqyrtim nga OE ankues Noti dhe Bini dhe pas shqyrtimit të kërkesës me date 17.07.2019 kemi refuzuar kërkesën për rishqyrtim dhe qëndrojmë prapa vendimit të Autoriteti Kontraktues. Është eliminuar për çmimet abnormalisht të ulëta. Sa i përket për OE të rekomanduar ai i ka pas disa pozicione me të favorshme dhe si kemi kërkuar sqarim.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti profesional i prokurimit z. Bushi deklaroj: Ne i kemi shqyrtuar pretendimet ankimore kemi paraqitur edhe pozicionet për çka KK-Prishtinë i ka konsideruar çmime jo normalisht të ulte përgjigjet janë konkretisht ne përgjigjen nr 1, janë disa artikuj me çmime nga 10 cent, 20, 50, 1, 1.80 euro mirëpo sipas formulës për rregulla për tender jo normalisht të ulët OE ankues nuk eliminohet nga gara sipas formulës.

Pretendim tjetër ka qenë OE të rekomanduar ka pasur një pozicion të pa plotësuar pozicioni 1.13 për atë edhe kam rekomanduar që lënda të kthehet në rivlerësim të kërkohej sqarime shtese për pozicione dhe ne rast se dyshon Autoriteti Kontraktues se nuk mund ti ekzekutoj sipas çmimeve të ofruara punimet të

kërkohet rritja e sigurimit të ekzekutimit sipas nenit 41.15 të RRUOPP-së, për këtë kam kërkuar që lënda të kthehet ne rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Binaku deklaroj: i propozoj panelit shqyrtues ta aprovoj ankesën tone si te bazuar dhe lenden ta kthej ne rivlerësim

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Sallahu deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues që ankesa e OE-së hudhet poshtë si e pa bazuar dhe të mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton si me poshtë:

Lidhur me pretendimet e OE ankues për disa pozicione që AK i ka klasifikuar si çmime jo-normalisht të ulëta për OE ankues, në ankesën e tij sqaron se nga AK me dt :29.05.2019 kemi pranuar kërkesë për sqarime lidhur me pozicionet :

Pozicioni nr. 1 nen pozicioni 1,2 dhe 1.10;

Pozicioni 2 nen pozicioni 2.1;2.2;2.3;2.4 dhe 2.5

Pozicioni 3 nen pozicioni 3.1;3.2 dhe 3.6

Pozicioni 7 nen pozicioni 7.1;7.2;7.3 dhe 7.4

Pozicioni 1 nen pozicioni 1.1;1.3 dhe 1.4

Pozicioni 3 nen pozicioni 3.2

Pozicioni 1 nen pozicioni 1.1.1;1.1.2;1.1.3 dhe 1.1.4

Pozicioni 3 nen pozicioni 3.3.1

Paneli shqyrtues sqaron se në pozicionet që pretendon AK-Komuna e Prishtinës së OE ankues ka çmime jo-normalisht të ulëta, ne përmasën dhe parallogarite e OE ankues gjinden disa pozicione që OE ankues ka këto çmime:

Pozicioni 1 (Punët paraprake) - Poz. 1.1=0.10 € ; Poz. 1.2=0.10 €; Poz. 1.10= 0.50 €.

Pozicioni 2 (Punimet e dheut) - Poz. 2.1 = 0.70 € ; Poz. 2.2 = 0.10 €; Poz. 2.3 = 0.20 €; Poz. 2.4 = 1.80 €
Poz 2.5 = 5.00 €.

Pozicioni 3 (Mbistruktura) - Poz. 3.1 = 5.00 €; Poz. 3.2 = 5.00 € ; Poz. 3.6 = 9.00 €.

Pozicioni 7 (Sinjalizimi horizontal)-Poz.7.1 = 1.00 €; Poz.7.2 = 1.00 €; Poz.7.3 = 1.00 €; Poz.7.4=3.00€.

Pozicioni 1.0 (Punët e dheut)- Poz. 1.1 = 0.10 € ; Poz. 1.3 = 0.70 € ; Poz. 1.4 = 0.70 €.

Pozicioni 3.0 (Punët metal punuese) - Poz. 3.1 = 70.00 €.

Pozicioni 1 (Instalimet elektrike) - Poz. 1.1.1 = 0.70 €; Poz. 1.1.2 = 4.20 €; Poz. 1.1.3 = 1.50 €

Poz. 1.1.4 = 0.90 €.

Pozicioni 3 (Zhvendosja dhe rehabilitimi i rrjetës ekzistuese ne trase te re) - Poz. 3.3.1 = 3.00 €.

AK duke marr për baze formulën për rregulla jo-normalisht të ulëta ka qene dashtë të beje krahasimin dhe të shikojë mundësitë për kryerjen apo moskryerjen e këtij projekti nga OE ankues (NOTI & BINI), pasi qe neni 61 i LPP-se dhe rregullat për tender jo normalisht të ulët e përcaktojnë qartë Çmimin jo-normalisht te ulët.

Pasi qe Neni 1 (qëllimi) paragrafi 1.2 i Rregullave për Tender Jo-Normalisht të ulet (citim):

1.2 Në çdo rast , kur ka një prag për tender jo-normalisht të ulet, ndalohet përjashtimi automatik i ofertave jo-normalisht të ulëta pa përdorur një procedurë interpartes me operatorin përkatës ekonomik për shqyrtimin e tenderit i cili konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normalisht i ulët.

Paragrafi 3 & paragrafi 4 i kësaj rregullore e përcakton metodën e krahasimit te ofertave me çmim jo normalisht te ulët.

Neni 3 i Rregullores për Tender Jo-Normalisht te Ulët:

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen te gjitha kushtet e mëposhtme:

i.çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;

i.i.çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;

i.i.i. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

3.2 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht te ulët për arsye të tjera nga ato te parashikuara në paragrafin 3.1 të këtyre rregullave, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.

Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton se AK duhet të përdorë formulën për Rregullat e Tenderëve me çmime jo-normalisht të ulëta, edhe nëse OE ankues eliminohet sipas formulës (Rregullat për Tender jo-normalisht te ulet) AK duhet ti kërkoj sqarime, pra patjetër duhet ta përdor procedurën “inter partes”, në rastin konkret OE ankues nuk eliminohet sipas formulës se “Rregullave për Tender jo-normalisht të ulët”, por ka çmime në disa pozicione të ulëta dhe AK duke u bazuar në këtë arsyetim e ka eliminuar OE ankues sipas nenit 61 te LPP-së.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontrate ka pozicione te pa plotësuar, AK duhet te analizoj te gjitha pozicionet e OE-ve.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 dhe 61 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna e Prishtinës

1x1 OE-“ Noti Construction”SH.P.K. & NNT “Bini”Obiliq.

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.